

**Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit**

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

**Aktivitetet përgjatë muajit Maj, 2023**

**Ministri i Drejtësisë fton në tryezë diskutimi për masat antikorrupsion përfaqësuesit e dhomave dhe shoqatave të biznesit**

**29.05.2023:** Bashkëpunimi me biznesin për politika të vlefshme antikorrupsion dhe masa eficiente veprimi për të garantuar shërbime më të mira publike, mbledhi bashkë në një tryezë diskutimi Ministrin e Drejtësisë në ushtrim të rolit të tij të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, z. Ulsi Manja, me drejtues e përfaqësues të dhomave dhe shoqatave të biznesit në vend. Tematika e takimit ishte bashkërendimi i masave për ndërhyrje dhe rritja e bashkëveprimit mes palëve. Ministri Manja paraqiti disa prej iniciativave kundër korrupsionit dhe raste të masave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ndaj nëpunësve drejtues dhe zbatues pranë autoriteteve ku është vendosur Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion. Në takim, pjesëmarrësit ndanë mendime dhe përvoja të vlefshme për të fuqizuar kapacitetet dhe ndërtuar ura të reja bashkëpunimi dhe me qëllim rritjen e besimit për vlerat dhe kapacitetet e profesionistëve kundër korrupsionit. Aktorët e sektorit privat kërkuan dhe propozuan pasjen e një roli më aktiv të Drejtërisë së Përgjithshme Antikorrupsion në parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin e luftës kundër korrupsionit në administratën publike edhe në sektorin privat. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion është struktura teknike e organizuar në nivel ekzekutiv për të luftuar korrupsionin dhe promovuar integritetin në administratën publike. Palët mbështetën dhe ofruan bashkëpunim të rregullt në vijim.




**Më shumë informacion mbi këtë takim, mund të gjeni në profilet sociale të Drejtërisë së Përgjithshme Antikorrupsion dhe në linkun:** [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=205621112416082&id=100089045846232](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=205621112416082&id=100089045846232)

**SHBA-të iniciatore e punimeve të Samitit të Evropës Jug-Lindore kundër krimit kibernetik, si një rrezik i shtuar në kryerjen e korrupsionit**

**21 - 23.05.2023:** Lufta kundër korrupsionit po shihet e shtrirë në shumë fusha dhe sektorë të shoqërisë, ekonomisë dhe të veprimit. Kësaj iniciative të marrë tashmë nën kujdesin e SHBA-ve dhe e cila po gjen zbatim në shumë vende, iu bashkuan edhe punimet e Samitit Ndërkombëtar të Drejtësisë për Luftën kundër Krimit Kibernetik - "Samiti i Evropës Jug-lindore i krimit kibernetik", në Sibenik, Kroaci. Ministria e Drejtësisë dhe e Administratës Publike të Kroacisë në bashkëpunim Departamentin e Drejtësisë të SHBA-ve, organizuan këtë takim me përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të vendeve të këtij rajoni. Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, z. Florin Demollari dhe prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme morën pjesë në takim dhe ndanë vullnetin dhe propozime për të rakorduar së bashku me vendet e tjera nismën për të gjetur masa dhe ndërhyrje të reja kundër fenomenit të krimeve kibernetike, si metoda dhe instrumente që rrezikojnë shërbimet dhe lidhen me krimin e korrupsionit, duke tejkaluar kufijtë e shteteve. Vendet anëtare dakordësuan edhe një Deklaratë të Bashkëpunimit në Luftën kundër Krimit Kibernetik, që do të iniciojë ngritjen e një Rrjeti të Evropës Jug-lindore, me përfaqësues ekspertë të gjyqësorit, me qëllim lehtësimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis organeve gjyqësore kompetente dhe shkëmbimin e eksperiencave, njohurive, dhe të praktikës lidhur me hetimet dhe dënimin e krimit kibernetik. Në vitin 2022, Shqipëria u sulmua nga metoda të krimit kibernetik që bllokuan për disa ditë shërbimet elektronike dhe shkëmbimin e komunikimit elektronik.

**Publikohet për konsultim publik raporti i monitorimit, janar - mars 2023, të Planit të Veprimit Antikorrupsion**

**30.05.2023:** Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, në përfundim të tre-mujorit të parë 2023, ka monitoruar zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion për këtë periudhë. Pas marrjes së të dhënave të para, është hartuar draft raporti i monitorimit dhe është kryer një analizë vlerësimi mbi progresin e Planit të Veprimit Antikorrupsion. Raporti jep informacion për 59 masa dhe 105 aktivitete të planifikuara për zbatim për këtë periudhë, në fusha të parandalimit – ndëshkimit – ndërgjegjësimin kundër korrupsionit. Nga monitorimi i kryer rezultoi se janë zbatuar plotësisht 33 masa/65 aktivitete, pjesërisht 17 masa/12 aktivitete dhe nuk janë zbatuar 9 masa/28 aktivitete. Raporti është në proces plotësimi dhe konsultimi me institucionet dhe bërë publik gjithashtu, për publikun e gjerë dhe OSHC-të. Fusha me nivel zbatimi të mirë në këtë periudhë janë: e-shërbimet publike, instalimi i e-regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve në 222 autoritete publike, miratimi i udhërrëfyesit mbi zbatimin e prokurimit publik të gjelbër, rritja e efikasitetit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe vijimi i ndërveprimit të masave ndëshkimore antikorrupsion në nivel administrativ dhe agjencitë ligjzbatuese (Polic-Prokurori). Me përfundimin e konsultimit dhe dakordësimin në nivel teknik, raporti do të diskutohet dhe miratohet në takimin e Grupit Tematik Antikorrupsion.



**Draft-Raportin e monitorimit e gjeni të publikuar në linkun:** <https://www.drejtësia.gov.al/raporte-monitorimi-2023/>

**Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion propozon 22 masa administrative dhe jep 22 rekomandime për raste kontrolli dhe dyshime për korrupsion**


**01 - 31.05.2023:** Drejtoria e Monitorimit të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion dhe Drejtoria Operacionale për Çështjet Antikorrupsion pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, kanë vijuar me marrjen e rasteve të dyshuara të korrupsionit. Përgjatë muajit maj, pranë dy strukturave të Drejtërisë së Përgjithshme Antikorrupsion janë marrë e administruar në total 29 ankesa dhe denoncime referuar aktivitetit të institucioneve të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, në të gjitha mënyrat e komunikimit (shkresor, email, platforma elektronike). Rastet i adresohen kryesisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive vendore të saj, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, etj. Pas verifikimit të hollësishëm të ankesave, janë hartuar 6 raporte përfundimtare në lidhje me hetimet e kryera, në të cilat janë identifikuar elementë të veprimtarive të parregullta. Në vijim, janë propozuar 22 masa për fillimin e ecursë disiplinore si dhe janë gjeneruar 22 rekomandime për të forcuar mekanizmat e kontrollit dhe parandalimit të korrupsionit. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion është e angazhuar për të ndërmarrë veprime të menjëhershme ndaj shkeljeve të dyshuara dhe për të promovuar integritetin dhe llogaridhënien në institucionet që operojnë në shërbim të qytetarëve.

**Denonconi raste dhe praktika abuzive në:** [koordinatoriak@drejtësia.gov.al](mailto:koordinatoriak@drejtësia.gov.al)



## UNODC zhvillon projekte bashkëpunimi me Drejtorinë e Politikave Antikorrupsion për hetimin e shpejtë të korrupsionit dhe edukimin kundër korrupsionit

**23 - 26.05.2023:** Programet e zhvillimit kundër korrupsionit në nivel rajonal kanë hyrë në një fazë të re zbatimi përmes hartimit të një Udhëzuesi praktik veprimi procedurash, për oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Aktiviteti ditor hetimor, proceset dhe procedurat do të përmbledhen në një dokument procedurash me udhëzime të detajuara, mbështetur në kuadrin ligjor, rregullator në fuqi, por edhe në veprimet procedurale të praktikës. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në bashkëpunim me UNODC, koordinon këtë proces në hartimin e këtij Udhëzuesi, veçanërisht për rastet e krimeve financiare edhe të rekuperimit të aseteve që vijnë nga krimi i korrupsionit. Një grup pune i përbërë nga prokurorë, oficerë të policisë së shtetit, ekspertë për pastrimin e parave dhe përfaqësues të ministrive të Drejtësisë dhe të Brendshme po hartojnë udhëzuesin, në zbatim të angazhimeve të marra në kuadër të Samitit të Berlinit. Gjithashtu, UNODC po bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion dhe Agjencinë e Parandalimit të Korrupsionit në Kosovë dhe me shoqëritë civile të të dy vendeve, për të promovuar raste dhe iniciativa të edukimit kundër korrupsionit. Në një tryezë të përbashkët u fol për projekte të kryera dhe shkëmbim të ideve për nisma dhe metoda të reja bashkëpunuese për edukimin kundër korrupsionit dhe kërkesat për bashkëpunim. Zyra Rajonale e UNODC për Evropën Juglindore i bashkohet interesave dhe kërkesave të Drejtorisë së Politikave Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, për të përmirësuar mënyrën e veprimit dhe për të ofruar më shumë iniciativa për edukim, arsim dhe publikime kundër korrupsionit.



Mësoni më shumë mbi këto iniciativa në profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në LinkedIn, Facebook e Twitter.

## Staf i Drejtorisë Antikorrupsion shton njohuritë në hetimin e rasteve të korrupsionit në projektet e investimeve ndërkombëtare


**18 - 19.05.2023:** Staf dhe profesionistë të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, të cilët janë të angazhuar në hetimin dhe verifikimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit në administratën publike, morën pjesë në një seminar ndërkombëtar të organizuar nga UNODC, në Kazakistan. Tema e seminarit ishte intensifikimi i hetimit të korrupsionit dhe forcimi i bashkëpunimit në projektet e investimeve ndërkombëtare. Në këtë aktivitet – trajnim, specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit ndanë përvojat e tyre në luftën kundër korrupsionit, për raste të ndjekura nga kjo drejtori dhe brenda mandatit ligjor e rregullator që gëzon. Objektivat kryesore të këtij seminary ishin rritja e ndërgjegjësimit për shkaqet dhe pasojat e korrupsionit në projektet e investimeve ndërkombëtare, si dhe forcimi i kapaciteteve profesionale dhe teknike të ekspertëve në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në projektet e investimeve. Takimi trajtoi me prioritet dhe vlerësoi me rëndësi se nëpërmjet shkëmbimit të praktikave, sfidave kombëtare dhe standardeve ndërkombëtare, mund të ndërtohej një ambient i përshtatshëm dhe favorizues për investimet, duke siguruar integritetin dhe përgjegjshmërinë e investitorëve vendas por edhe të huaj. Specialistë të drejtorisë u angazhuan në zgjidhjen e rasteve dhe ushtrimeve praktike, si potencial i mundshëm për të ndodhur edhe në vendin tonë.



## Konflikti i Interesave në Sektorin e Sigurisë si një mekanizëm i luftës kundër korrupsionit

**16 - 17.05.2023:** Konflikti i Interesave në sektorin e sigurisë mbledhi në një takim-trajnim rajonal në Podgoricë, Mal të Zi, specialistë të antikorrupsionit dhe të Ministrisë së Mbrojtjes. Takimi u organizua nga Qendra e RACVIAC, organizata rajonale kundër korrupsionit - RAI dhe Ministria e Mbrojtjes së Malit të Zi. Pjesëmarrës nga sektori i sigurisë të shumë vendeve të rajonit, trajtuan raste dhe diskutuan politika mbi konfliktin e interesave në nivel kombëtar. Gjatë dy ditëve të trajnimit u fol mbi ndikimin e konfliktit të interesave në vendimmarrjen, transparencën dhe besimin që duhet pasur në institucionet publike. Në takim u prezantua edhe raporti "*Rolling Back State Capture in Southeast Europe*", e hartuar dhe publikuar nga organizata SELDI, raport që thekson nevojën e përdorimit të mjeteve efektive për deklarimin e pasurisë dhe për personat e ekspozuar politikisht. Përfaqësuesit shqiptarë ndanë përvojën dhe arritjet e Shqipërisë në këtë fushë, gjithashtu. Ky takim i zhvilluar në një ambient aktiv dhe dinamik, u mundësoi të gjithë pjesëmarrësve të diskutojnë dhe të mësojnë për temat nga bashkëpunëtorët në sektorin e sigurisë dhe të konfliktit të interesave.

Më shumë informacion, mund të gjeni në link: <https://www.racviac.org/racviac-and-rai-workshop-on-conflict-of-interest-in-the-security-sector-commences-in-podgorica-me/?fbclid=IwAR2TFy9RhSPqXxy88qx-3F-0gBfZmE39WuHw5h1H6flq6OWxuwCY3bhduVg>



## Media dhe publiku, partnerë të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion

**12.05.2023:** Drejtori i Politikave Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, znj. Rovena Pregja, zhvilloi një bisedë televizive në stacionin SCAN TV. Tema e diskutuar ishin çështjet e politikave antikorrupsion, masat dhe objektivat e administratës shqiptare, si dhe roli i tyre në procesin e integritetit evropian. Përmes këtij bashkëpunimi me median, Ministria e Drejtësisë ka vendosur ura komunikimi dhe po rrit informimin e publikut mbi nismat e reja dhe proceset e bashkërendimit të akteve ligjore dhe kapaciteteve teknike në luftën kundër korrupsionit. Komunikimi me median dhe interesi i shtuar të gazetarëve mbi punën e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ofron më shumë informacion për qytetarët, duke i bërë ata pjesë të procesit të luftës kundër korrupsionit. Gjatë intervistës, u diskutuan edhe rastet e ndëshkimit dhe masat disiplinore të dhëna nga struktura antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë. Rolit të Ministrisë së Drejtësisë në procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian iu dha vëmendje e veçantë, duke treguar se angazhimi kundër korrupsionit është një prej kushteve primare për suksesin e këtij procesi. Bashkëpunimi me median theksoi rëndësinë e forcimit të bashkërendimit midis institucioneve publike dhe publikut në adresimin e çështjeve të korrupsionit dhe promovimin e ligjshmërisë dhe të llogaridhënies.



Intervistën e plotë mund ta aksesoni në: <https://www.youtube.com/watch?v=w22uyHMdy0Q>



Bulevardi "Zog I-rë", Tiranë



<http://www.drejtesia.gov.al>



[infoak@drejtesia.gov.al](mailto:infoak@drejtesia.gov.al)

